

Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës – Nr. 205

**Konventa e Këshillit të Evropës
mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare**

Tromsø, 18.06.2009

Hyrje

Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës dhe nënshkruesit e tjerë të këtij dokumenti,

Duke pasur parasysh se synimi i Këshillit të Evropës është të arrijë unitet më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim mbrojtjen dhe përmbushjen e idealeve dhe parimeve të cilat janë trashëgimia e tyre e përbashkët;

Duke pasur në mendje në veçanti nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nenet 6, 8 dhe 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Aarhus, 25 qershor 1998) dhe Konventën për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale të 28 janarit 1981 (ETS nr. 108);

Duke pasur në mendje gjithashtu Deklaratën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit, miratuar më 29 prill 1982, ashtu si edhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare nr. R (81) 19 mbi aksesin në informacionin që disponohet nga autoritetet publike, nr. R (91) 10 mbi komunikimin tek të tretët të të dhënave personale që disponohen nga autoritetet publike, nr. R (97) 18 në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe të përpunuara për qëllime statistikore, nr. R (2000) 13 mbi politikën evropiane të aksesit në arkiva dhe Rek. (2002) 2 mbi aksesin në dokumentet zyrtare;

Duke pasur parasysh rëndësinë në një shoqëri pluraliste dhe demokratike të transparencës nga ana e autoriteteve publike;

Duke vlerësuar se ushtrimi i të drejtës për akses në dokumentet zyrtare:

- i. Ofron një burim informacioni për publikun;
- ii. Ndhmon publikun në formimin e një opinioni mbi gjendjen e shoqërisë dhe mbi autoritetet publike;
- iii. Nxit integritetin, rendimentin, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i ndihmuar kështu në konfirmimin e legjitimiteti të tyre;

Duke pasur parasysh rrjedhimisht se të gjitha dokumentet zyrtare, janë publike në parim dhe mund të refuzohet aksesin në to vetëm për të mbrojtur të drejta të tjera dhe interesa legjitime,

Ranë dakord për si vijon:

Kapitulli I

Neni 1 – Dispozita të përgjithshme

1. Parimet e renditura në vijim duhet të konsiderohen të tilla që nuk çënojnë ato ligje e rregullore kombëtare dhe traktate ndërkombëtare, të cilat njohin të drejta më të gjera të aksesit në dokumentet zyrtare.

2. Për qëllime të kësaj Konvente:

a i “autoritete publike” do të thotë:

- 1 qeverisje dhe administratë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
- 2 organe legjislative dhe autoritete gjyqësore, për aq sa ato ushtrojnë funksione administrative, në përputhje me të drejtën kombëtare;
- 3 persona fizikë apo juridikë, për aq sa ata ushtrojnë autoritet administrativ.

ii Secila Palë ka mundësi, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, njohjes, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se përkufizimi i “autoriteteve publike” përfshin gjithashtu një apo më shumë nga të mëposhtmet:

- 1 organe legjislative sa i takon aktiviteteve të tyre të tjera;
- 2 autoritete gjyqësore sa i takon aktiviteteve të tyre të tjera;
- 3 persona fizikë apo juridikë, për aq sa ata ushtrojnë funksione publike apo ushtrojnë aktivitetin me fonde publike, në përputhje me të drejtën kombëtare.

b “dokumente zyrtare” do të thotë çdo informacion i regjistruar në çdo lloj forme, i hartuar apo i përfutur dhe i ruajtur nga autoritetet publike.

Neni 2 – E Drejta për akses në dokumente zyrtare

- 1 Secila Palë duhet të garantojë të drejtën e çdo personi, pa asnjë lloj diskriminimi, të ketë akses, sipas kërkesës, në dokumentet zyrtare që ruhen nga autoritetet publike.
- 2 Secila Palë duhet të marrë masat e nevojshme në ligjin kombëtar, për zbatimin e dispozitave për akses në dokumente zyrtare, të përcaktuara në këtë Konventë.
- 3 Këto masa nga Palët, duhet të merren jo më vonë se sa data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 3 – Kufizimet e mundshme të aksesit në dokumentet zyrtare

- 1 Secila Palë mund të kufizojë të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. Kufizimet duhet të përcaktohen saktësisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë proporcionale me për qëllime të mbrojtjes së:
 - a sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
 - b sigurisë publike;
 - c parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së aktiviteteve kriminale;
 - d hetimeve disiplinore;
 - e inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së autoriteteve publike;
 - f privatësisë dhe interesave të tjera të ligjshme;
 - g interesave tregtare dhe interesave të tjerë ekonomike;
 - h politikave ekonomike, monetare dhe të valutës të Shtetit;
 - i barazisë së palëve në procedimet gjyqësore dhe administrimit të efektshëm të drejtësisë;
 - j mjedisit; ose

k diskutimeve brenda apo ndërmjet autoriteteve publike, në lidhje me shqyrtimin e një çështjeje.

Shtete e përfshira kanë mundësi, në momentin e nënshkrimit ose kur deponon instrumentin e tij të ratifikimit, njohjes, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojnë se komunikimet e Familjes mbretërore dhe Oborrit të saj ose Kreut të Shtetit, duhet gjithashtu të përfshihen ndërmjet kufizimeve të mundshme.

- 2 Akcisi në informacionin që përmban një dokument zyrtar, mund të refuzohet, nëse publikimi i tij ka mund ose ka të ngjarë të dëmtojë interesat e përmendura në paragrafin 1, përveçse nëse ka një interes prevalues publik në lidhje me publikimin e tij.
- 3 Palët duhet të marrin në konsideratë përcaktimin e afate kohore, përtej së cilave, kufizimet e përmendura në paragrafin 1, nuk gjejnë më zbatim.

Neni 4 – Kërkesat për akses në dokumentet zyrtare

- 1 Personi që aplikon për një dokument zyrtar nuk duhet të jetë i detyruar të parashtojë arsye për të pasur akses në dokumentin zyrtar.
- 2 Palët mund t'i japin personit që aplikon, të drejtën për të mbetur anonim, përjashtuar rastin kur dhënia e identitetit është thelbësor, me qëllim përpunimin e kërkesës.
- 3 Formalitetet për kërkesat, duhet të përfshijnë vetëm ato që janë thelbësore për përpunimin e kërkesës.

Neni 5 – Përpunimi i kërkesave për akses në dokumentet zyrtare

- 1 Autoriteti publik duhet të ndihmojë personin që aplikon, brenda mundësisë së arsyeshme, të identifikojë dokumentin zyrtar.
- 2 Kërkesa për akses në një dokument zyrtar, duhet të trajtohet nga çdo autoritet publik që disponon dokumentin. Nëse autoriteti publik nuk e disponon dokumentin zyrtar të kërkuar, pse nëse ai nuk është i autorizuar të përpunojë atë

kërkesë, ai duhet, nëse është e mundur, t'ia përcjellë aplikimin ose personin që aplikon, autoritetit publik kompetent.

- 3 Kërkesat për akses në dokumente zyrtare, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.
- 4 Kërkesa për akses në një dokument zyrtar duhet të trajtohet me shpejtësi. Vendimi duhet marrë, komunikuar dhe ekzekutuar sa më shpejt të jetë e mundur, ose brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili është bërë i ditur paraprakisht.
- 5 Një kërkesë për akses në dokumente zyrtare mund të refuzohet:
 - i nëse, me gjithë ndihmën e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa nuk është aq e qartë, sa të mundësojë identifikimin e dokumentit zyrtar; ose
 - ii nëse kërkesa është dukshëm e paarsyeshme.
- 6 autoriteti publik që refuzon aksesin në një dokument zyrtar, duhet të parashtrojë pjesërisht apo plotësisht arsyet për këtë refuzim. Personi që aplikon, duhet të përftojë, me anë të kërkesës, shpjegimin me shkrim nga ana e atij autoriteti publik, në lidhje me refuzimin.

Neni 6 – Mënyrat e aksesit në dokumentet zyrtare

- 1 Kur jepet akses në një dokument zyrtar, personi që aplikon, ka të drejtë të zgjedhë nëse do të shqyrtojë origjinalin apo një kopje të tij, ose të përfitojë një kopje të tij, në çdo lloj formati të disponueshëm, ose formati të përzgjedhur nga ai ose ajo, përveçse nëse preferenca është e paarsyeshme.
- 2 Nëse në një dokument zyrtar, për disa nga informacionet e tij zbatohen kufizime, gjithsesi autoriteti publik duhet të japë akses në informacionin e mbetur që përmban dokumenti. Çdo pjesë e hequr prej tij duhet të bëhet e ditur qartësisht. Gjithsesi, nëse varianti i pjesshëm i dokumentit është çorientues ose i pakuptimtë, ose nëse ai përbën një ngarkesë të paarsyeshme për autoritetin për vënien në dispozicion të pjesës së mbetur të dokumentit, aksesin në të mund të refuzohet.
- 3 Autoriteti publik mund të japë akses në një dokument zyrtar duke i ofruar personit që aplikon, burime alternative lehtësisht të aksesueshme.

Neni 7 – Tarifat për akses në dokumente zyrtare

- 1 Këqyrja e dokumenteve zyrtare, në ambientet e autoritetit publik, duhet të jetë pa pagesë. Diçka e tillë nuk i pengon Palët të përcaktojnë tarifa për këto shërbime, të ofruara nga arkivat dhe muzetë.
- 2 Një tarifë mund të caktohet kundrejt personit që aplikon, për një kopje të dokumentit zyrtar, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe të mos tejkalojë kostot e riprodhimit dhe dorëzimit të dokumentit. Tarifat e pagesave duhet të publikohen.

Neni 8 – Procedura e ankimit

- 1 Një personi që aplikon, kërkesa e të cilit për një dokument zyrtar është refuzuar, shprehimisht apo tërthorazi, qoftë pjesërisht apo plotësisht, duhet të ketë mundësi të kryejë procedurë ankimi pranë një gjykate apo një organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të përcaktuar me ligj.
- 2 Një person që aplikon duhet të ketë gjithnjë mundësi të kryejë një procedurë të shpejtë dhe jo të kushtueshme ankimi, që përfshin qoftë një rishqyrtim nga një autoritet publik ose ankim në përputhje me paragrafin 1.

Neni 9 – Masat plotësuese

Palët duhet të informojnë publikun mbi të drejtat e tij për akses në dokumentet zyrtare dhe se si ajo e drejtë mund të ushtrohet. Ato duhet gjithashtu të marrin masat e nevojshme për:

- a të edukuar autoritetet publike mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me zbatimin e kësaj të drejte;
- b të dhënë informacion në lidhje me aktivitetet për të cilat ato janë përgjegjëse;
- c menaxhuar dokumentet e tyre me efikasitet, në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të aksesueshme; dhe
- d të zbatuar rregulla të qarta dhe të përcaktuara, për ruajtjen dhe shkatërrimin e dokumenteve të tyre.

Neni 10 – Dokumentet të bëra publike me iniciativën e autoriteteve publike

Një autoritet publik, me iniciativë apo kur është e përshtatshme, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të bërë publike dokumentet zyrtare që ai zotëron, në interes të promovimit të transparencës dhe rendimentit të

administratës publike dhe për të nxitur pjesëmarrjen e informuar nga ana e publikut, për çështje të interesit të përgjithshëm.

Seksioni II

Neni 11 – Grup Specialistësh për Aksesin në Dokumentet Zyrtare

- 1 Një Grup Specialistësh për Aksesin në Dokumentet Zyrtare, duhet të zhvillojë takime, të paktën një herë në vit, me qëllim monitorimin e zbatimit të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht:
 - a për të raportuar mbi mjaftueshmërinë e masave të marra nga Palët, në ligj dhe në praktikë, me qëllim vënien në zbatim të dispozitave të përcaktuara në këtë Konventë;
 - b
 - i për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me zbatimin e kësaj Konvente;
 - ii për të paraqitur propozime për lehtësimin ose përmirësimin e përdorimit të efektshëm dhe zbatimit të kësaj Konvente, përfshirë edhe identifikimin e çdo problematike;
 - iii për të shkëmbyer informacion dhe për të raportuar mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore, të politikave ose ato teknologjike;
 - iv për të bërë propozime tek Konsultimi i Palëve për amendimin e kësaj Konvente;
 - v për të sendërtuar opinionin e tyre në lidhje me çdo propozim për amendim të kësaj Konvente, të bëra në përputhje me Nenin 19.
- 2 Grupi i Specialistëve mund të kërkojë informacion ose mendimet e shoqërisë civile.
- 3 Grupi i Specialistëve duhet të përbëhet nga e pakta 10 dhe e shumta 15 anëtarë. Anëtarët zgjidhen nga Konsultimi i Palëve, për një afat prej katër vitesh, me të drejtë të vetëm një rizgjedhjeje, nga një listë ekspertësh, ku secila Palë propozon dy ekspertë. Ata duhet të përzgjidhen prej personave që kanë integritetin më të lartë, të njohur për njohuritë e tyre në fushën e aksesit në

dokumentet zyrtare. Vetëm një anëtar mund të zgjidhet nga lista e propozuar nga secila Palë.

- 4 Anëtarët e Grupit të Specialistëve duhet të mbështeten në aftësitë e tyre individuale, të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe nuk duhet të pranojnë asnjë lloj udhëzimi nga qeveritë.
- 5 Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Grupit të Specialistëve duhet të përcaktohet nga Komiteti i Ministrave, pas konsultimit me të dhe pas marrjes së miratimit unanimit të Palëve të kësaj Konvente, brenda një viti që nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Grupi i Specialistëve duhet të miratojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 12 – Konsultimi i Palëve

- 1 Konsultimi i Palëve duhet të përbëhet nga një përfaqësues prej secilës Palë.
- 2 Konsultimi i Palëve duhet zhvillohet me qëllim që:
 - a të shqyrtojë raportet, opinionet dhe propozimet e Grupit të Specialistëve;
 - b të paraqesë propozime dhe rekomandime tek Palët;
 - c të bëjë propozime për amendime të kësaj Konvente, në përputhje me Nenin 19;
 - d të sendërtojë opinionin e vet në lidhje me çdo propozim për amendim të kësaj Konvente, të bërë në përputhje me Nenin 19.
- 3 Konsultimi i Palëve duhet të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, me qëllim që të zgjidhen anëtarët e Grupit të Specialistëve. Në vijim, ai duhet të mbledhet të paktën një herë në 4 vite dhe në çdo rast, kur shumica e Palëve, Komiteti i Ministrave ose Sekretari i Përgjithshëm i Evropës kërkon mbledhjen e tij. Konsultimi i Palëve duhet të miratojë rregullat e veta të procedurës.
- 4 Pas çdo mbledhjeje, Konsultimi i Palëve duhet t'i paraqesë Komitetit të Ministrave raportin e aktivitetit.

Neni 13 – Sekretariati

Konsultimi i Palëve dhe Grupi i Specialistëve duhet të asistohet nga Sekretariati i Këshillit të Evropës për përmbushjen e funksioneve të tyre, në zbatim të këtij Seksioni.

Neni 14 – Raportimi

- 1 Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, sa i takon një Pale Kontraktuese, kjo e fundit duhet t'i transmetojë Grupit të Specialistëve një raport, i cili duhet të përmbajë të gjithë informacionit e plotë mbi masat legislative e të tjera, të ndërmarra për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.
- 2 Që këtej e tutje, secila Palë duhet t'i transmetojë Grupit të Specialistëve, përpara çdo mbledhjeje të Konsultimit të Palëve, një përditësim të informacionit të përmendur në paragrafin 1.
- 3 Secila Palë duhet t'i transmetojë gjithashtu Grupit të Specialistëve çdo informacion që ai kërkon, për përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 15 – Publikimi

Raportet e paraqitura tek Grupi i Specialistëve, raportet, propozimet dhe opinionet e Grupit të Specialistëve dhe raportet e aktivitetit të Konsultimit të Palëve, duhet të bëhen publike.

Seksioni III

Neni 16 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Konventës

- 1 Kjo Konventë duhet të jetë e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.
- 2 Kjo Konventë është subjekt ratifikimi, pranimi apo miratimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi apo miratimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 3 Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës, pas datës së përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës në të cilën 10 Shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur miratimin e tyre që kjo Konventë të jetë e detyrueshme për ta, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.
- 4 Sa i takon çdo Shteti Nënshkrues, i cili shpreh në vijim miratimin e tij, që Konventa të jetë e detyrueshme për të, ajo do të hyjë në fuqi ditën e parë, të muajit pas përfundimit të një periudhe prej tre muajsh, pas datës së shprehjes së miratimit që Konventa të jetë e detyrueshme për të, në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

Neni 17 – Aderimi në Konventë

- 1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, mund të ftojë çdo Shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës apo çdo organizatë ndërkombëtare, që të aderojë në këtë Konventë, pasi të konsultohet me Palët në Konventë dhe të marrë pëlqimin e tyre unanimit. Vendimi duhet të merret nga shumica e parashikuar në Nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votim unanimit të përfaqësuesve të Palëve, anëtare të Komitetit të Ministrave.
- 2 Sa i takon çdo Shteti apo organizate ndërkombëtare që aderon në këtë Konventë, sipas paragrafit 1 të mësipërm, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë, të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 18 – Zbatimi territorial

- 1 Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi, miratimit apo aderimit, të përcaktojë territorin apo territoret në të cilat do të gjejë zbatim Konventa.
- 2 Çdo Shtet, ka mundësi pas disa kohësh, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër, të përcaktuar në deklaratë, për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilit është përgjegjës. Sa i takon këtij territori, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh, pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.
- 3 Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në të, mund të anulohet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Anulimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 19 – Amendimet e Konventës

- 1 Amendimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Palë, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, Grupi i Specialistëve ose Konsultimi i Palëve.

- 2 Çdo propozim për amendime, duhet t'i komunikohet Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
- 3 Çdo amendim duhet t'i komunikohet Konsultimit të Palëve, i cili, pasi të konsultohet me Grupin e Specialistëve, duhet t'ia paraqesë opinionin e tij mbi amendimin e propozuar Komitetit të Ministrave.
- 4 Komiteti i Ministrave duhet të shqyrtojë amendimin e propozuar dhe çdo opinion të paraqitur nga Konsultimi i Palëve dhe mund të miratojë amendimin.
- 5 Teksti i çdo amendimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 4, duhet t'i përcillet Palëve për pranim.
- 6 Çdo amendim i miratuar në përputhje me paragrafin 4, duhet të hyjë në fuqi ditën e parë, të muajit pas përfundimit të periudhës prej një muaji, pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

Neni 20 – Deklaratat

Secila Palë ka mundësi, në momentin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, të paraqesë një apo më shumë deklarata, të parashikuara në Nenet 1.2, 3.1 dhe 18. Ajo duhet të njoftojë çdo ndryshim të këtij informacioni tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 21 – Tërheqja

- 1 Secila Palë mundet në çdo moment, të tërhiqet nga kjo Konventë, duke i dërguar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 2 Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej gjashtë muajsh, pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 22 – Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës duhet të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe çdo Shtet dhe organizatë ndërkombëtare që kanë aderuar apo janë ftuar të aderojnë në këtë Konventë në lidhje me:

- a çdo nënshkrim;

- b për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit;
 - c për çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me Nenet 16 dhe 17;
- për çdo deklaratë të bërë sipas Neneve 1.2, 3.1 dhe 18;
- d për çdo akt, njoftim apo komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Kryer në Tromsø, datë 18 qershor 2009, në gjuhët angleze dhe franceze, të dy tekstet e të cilave janë njësoj autentikë, në një kopje të vetme e cilat do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i përcjellë kopje të certifikuara secili Shteti Anëtar të Këshillit të Evropës dhe tek secili Shtet apo organizatë ndërkombëtare, që është ftuar për të aderuar në këtë Konventë.